



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

**MBI**

**MIRATIMIN E DATAVE TE KONKURSIT TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË  
STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 të MASR “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2018-2019”, në Udhëzimin nr. 22, datë 20.06.2018 të MASR “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2018-2019”, Rektorati

**V E N D O S I:**

1. Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve brenda 10 Gushtit 2018 shkarkon nga Portali U-albania listën e aplikantëve konkurues sipas programeve të studimit dhe ia përcjell fakulteteve.
2. Fakultetet më datë 10 Gusht 2018 afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqen zyrtare elektronike listën e aplikantëve për konkurim.
3. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve për vitin akademik 2018-2019 të jetë **13-16 gusht 2018**, nga ora 9<sup>00</sup>-16<sup>00</sup> (aplikantët para se të bëjnë pagesën të verifikojnë emrin në listat e afishuara në UST)
4. **18 gusht** shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurim në UST.
5. Datat e konkursit praktik në FSHL të jenë **20-23 gusht 2018**.
6. Datat e konkursit praktik në FVFR të jenë **24-26 gusht 2018**.
7. Tarifa e regjistrimit për konkurs propozohet të jetë 5 000 lekë dhe i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit .
8. Tarifa e regjistrimit për fituesit propozohet të jetë 2 000 lekë dhe i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit .

9. Dokumentat që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurs do të jenë:
  - 2 fotografi dokumenti 4x6
  - Fotokopje kartës së identitetit
  - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
  - Kartela mjekësore
10. Të dhënat për Rregulloren e konkursit, testeve praktike, kartelës mjekësore dhe fatura e tarifës konkurimit gjenden në faqen zyrtare të UST.
11. Brenda datës 27 Gusht 2018, Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre. Ngarkohet një kopje elektronike e këtyre listave në portalin U-albania dhe e përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike në QSHA.
12. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Dekanatet, Administratorja dhe Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimit, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Teknologjisë së Informacionit.
13. Ky vendim shpallet në faqen zyrate të UST-së.
14. Ky vendin hyn në fuqi menjëherë.

## **REKTOR**

**Prof. Dr. Agron CUKA**